

Thirrje për Pjesëmarrës: Trajnim për Trajnues (ToT) dhe Zhvillim të Punëtorive për Video në Mënyrë Participative

A jeni të interesuar të zgjeroni njohuritë tuaja për xhirim filmash me smartfon dhe të mësoni si të integroni metodat e videos participative në aktivitetet tuaja të ardhshme? Në qoftë se po, bashkohuni me ne në Serbi për një mundësi të veçantë për të përforcuar aftësitë tuaja për video participative dhe për të kontribuar në përmirësimin e pjesëmarrjes sociokulturore të njerëzve në lëvizje dhe popullsive vendase në Ballkanin Perëndimor!

Rreth Projektit: Projekti rajonal "Pjesëmarrja Sociale e Njerëzve në Lëvizje dhe Popullsive Vendase në Rajonet e Ballkanit Perëndimor", i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe i zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), synon të përmirësojë pjesëmarrjen sociokulturore përmes zhvillimit të aftësive individuale të njerëzve në lëvizje dhe anëtarëve të popullsive vendase. Në të njëjtën kohë, projekti synon të përmirësojë dhe forcojë ndërveprimin social midis tyre.

Rreth Trajnimit: Si pjesë e këtij projekti, organizojmë një trajnim pesëditësh për trajnues (ToT) për Filmim Videosh në mënyrë Participative, me qëllim që të përdorim fuqinë e rrëfimit vizual për t'ju dhënë zë njerëzve në lëvizje dhe popullsive vendase. Përmes ushtrimeve praktike dhe trajnimit teorik, pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri të vlefshme për teknikat bazike të filmimit, aftësitë e montazhit dhe intervistimit, si dhe metodat e prodhimit të videove participative dhe të gjitha mjetet e nevojshme didaktike për të zbatuar një punëtori të tyre për filmim. Në fund të trajnimit, do të keni kaluar procesin e prodhimit të një filmi të shkurtër, që nga skenari e deri te montazhi. Gjithashtu, filmi juaj mund të bëhet pjesë e një koleksioni më të madh që do të shfaqet në ngjarje publike për të festuar dialogun dhe diversitetin. Do të largoheni nga ky trajnim me vetëbesimin për ta zbatuar këtë metodë, si një vegël të re për angazhim në punën tuaj dhe pas përfundimit do të merrni një certifikatë.

Rreth Punëtorisë për Video në Mënyrë Participative: Pas trajnimit për trajnues (ToT), disa nga pjesëmarrësit do të ftohen të marrin pjesë në punëtorinë e dytë për video participative ku do të kenë mundësinë të përdorin aftësitë e tyre të reja dhe të prodhojnë filma të shkurtër së bashku me njerëzit në lëvizje dhe anëtarët e bashkësisë lokale në Serbi. Në ditën e fundit të punëtorisë, do të organizohet një eveniment ku do të shfaqen filmat. Kjo ngjarje do të bashkojë palë të ndryshme, duke siguruar një platformë për dialog dhe për promovim të kohezionit social.

Të dy trajnimet do të drejtohen nga [Kerstin Rickermann](#) - Këshilltare për Angazhim dhe Pjesëmarrje dhe Ko-Drejtoreshë e Glocal Films dhe [Foteini Foteinaki](#) - Krijuese për Art&Media dhe Edukatore dhe do të zhvillohen në gjuhën angleze.

Detajet e Trajnimit:

- **Pjesëmarrësit:** i hapur për pjesëmarrës nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut
- **Datat dhe vendi:**
 - Trajnimi për Trajnues do të zhvillohet në Beograd, Serbi, nga data **07 deri më 11 tetor 2023**
 - Punëtorja për Video në Mënyrë Participative do të zhvillohet në Beograd, Serbi, nga **data 14 deri më 15 tetor 2023**

Shpenzimet: Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për pjesëmarrësit që udhëtojnë jashtë Beogradit dhe jashtë Serbisë do të mbulohen nga organizatori.



Implemented by:
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Kush mund të aplikojë? I ftojme organizatat dhe institucionet të nominojnë individë që kanë dëshirë të kenë ndikim pozitiv përmes xhirimit të videove participative. Gjithashtu, ju bëjmë thirrje të veçantë individëve të rinj që aktualisht punojnë ose studiojnë në fushat e kinematografisë, gazetarisë, shkencave shoqërore, etnografisë, antropologjisë ose në disiplina të ngjashme.

Si të aplikoni: Që të aplikoni, ju lutemi dorëzoni nominimin tuaj ose aplikimin tuaj personal (duke dërguar CV-në tuaj), në të cilin shfaqni interesimin tuaj për filmim participativ. Shënoni, gjithashtu, edhe nivelin tuaj të njohjes së gjuhës angleze, që të mund organizojmë përkthim, në qoftë se është e nevojshme. Ju lutemi dërgoni aplikacionet tuaja përmes e-mailit në adresën: ema.kuzmanovska1@giz.de.

Afati përfundimtar për aplikim: Aplikoni deri më **20.09.2023**. Të gjithë kandidatët do të informohen për statusin e aplikimit të tyre shumë shpejt pas përfundimit të thirrjes.

Për informata shtesë, ju lutemi kontaktoni deniz.sulejman@giz.de.